



VENDIM

Nr.72 Datë 09.08.2011

**PËR
MIRATIMIN E TRANFERIMIT TË ASETIT, PËRKATËSISHT
NËNSTACIONIN 110/20KV TË “KALIMASHIT” NGA OST SH.A
TEK SHOQËRIA “CEZ SHPËRNDARJE” SH.A**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licensës “Për Aktivitetin e Transmetimit të Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.08.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të asetëve nga shoqëria OST sh.a tek Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “OST” sh.a plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plote e të licensuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, Përshkrimi i të licensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)



Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë transferimin e asetit, përkatësisht nënstationin 110/20kv të “Kalimashit”, nga “OST” sh.a tek shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI